

MBROJTËSI

Nr. 15 / 2024

www.kosovopolice.com



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo - Republika Kosovë
Zyra e Kryeministrit - Office of the Prime Minister

Nën patronatin e Kryeministrit të Republikës së Kosovës,
S.H.T. Albin Kurti, organizohet:

AKADEMI PËRKUJTIMORE

Në njëvjetorin e rënies së Heroit të
Republikës së Kosovës

AFRIM BUNJAKU



AFRIM BUNJAKU
HERO I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Heroizmi dhe përkushtimi i Policisë për ruajtjen e rendit kushtetues



Editorial

Ngjarjet e fundit në veri të vendit, siç ishte sulmi terrorist i ndodhur në fshatin Banjskë të Zveçanit, në shtator të vitit 2023, ku në mbrojtje të rendit kushtetues ra heroikisht rreshter Afrim Bunjaku, na e rikujtojnë sakrificën dhe përkushtimin e përditshëm të zyrtarëve të Policisë së Kosovës. Ky sulm terrorist, i drejtuar kundër vetë themeleve të sigurisë publike, tregoi edhe një herë se sfidat ndaj paqes dhe stabilitetit mbeten të pranishme. Megjithatë, falë përgatitjes dhe përkushtimit të Policisë, vetëmohimit të heroit Bunjaku dhe zyrtarëve policorë, u arrit të dëbohen terroristët, disa të arrestohen e të neutralizohen, duke rikthyer rendin dhe qetësinë në komunitet, si dhe duke parandaluar aneksimin e asaj zone në veri të vendit.

Ky akt heroik nuk ishte thjesht një rastësi, por një shprehje e vlerave të larta që mbartin zyrtarët e policisë: guxim, vendosmëri dhe ndjenjë të lartë detyre ndaj qytetarëve. Sakrifika e heroit Bunjaku që dha jetën në këtë betejë të pabarabartë meriton respektin dhe mirënjohjen e gjithë shoqërisë dhe kolegëve. Ai nuk mbrojti vetëm rendin dhe sigurinë, por mbrojti vendin dhe parimin se askush nuk duhet të jetë mbi ligjin dhe se siguria publike dhe rendi kushtetues është një e drejtë themelore për të gjithë qytetarët, pa dallim.

Policia tregoi profesionalizëm dhe vendosmëri në zbatimin e ligjit dhe ndëshkimin e atyre që kërkojnë ta cenojnë stabilitetin e Republikës së Kosovës. Arrestimi, neutralizimi dhe dëbimi i terroristëve ishin një mesazh i qartë se shteti nuk do të tolerojë akte terroriste që cenojnë sigurinë kombëtare dhe qytetare. Aksioni ishte një shembull frymëzues i bashkëpunimit, guximit dhe profesionalizmit që duhet të vazhdojë të karakterizojë punën e Policisë.

Në kohë sfidash, Policia mbetet e përkushtuar për mbrojtjen e rendit kushtetues dhe sigurisë publike, për mbrojtjen e pronës publike dhe asaj private, pavarësisht rreziqeve dhe sakrificave, zyrtarët e policisë vazhdojnë të jenë në vijën e parë të luftës kundër terrorizmit, krimit dhe elementeve që kërkojnë të destabilizojnë vendin. Detyra e tyre nuk është vetëm një profesion, por një mision i shenjtë për të mbrojtur lirinë, vendin, jetën dhe pronën e qytetarëve tanë.

Ndërsa kujtojmë heroin Bunjaku që ra në krye të detyrës, ne të gjithë duhet të reflektojmë mbi rolin jetik që Policia luan në shoqërinë tonë. Le të mbështesim punën e zyrtarëve policorë dhe të vlerësojmë sakrificat që secili zyrtar bën për një të ardhme më të sigurt dhe të qetë. Vetëm duke qëndruar të bashkuar dhe në zbatim të detyrave tona mund të mbrojmë rendin kushtetues dhe vlerat e demokracisë sonë të përbashkët.

Baki Kelani
Kryeredaktor

Revista 'Mbrojtësi' - Revistë e Policisë së Kosovës

Botues: ZIMP - Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun e PK-së - DPP - Prishtinë

Kryeredaktor: Baki Kelani, **Redaktor përgjegjës:** Daut Hoxha, **Dizajn - grafik:** Çajup Kajtazi, **It-Multimedia:** Arbër Muhadri,

Redaksia: Luljeta Mehmeti Quigley, Bajram Krasniqi, Arlinda Rexhepi - Gërxhaliu

Lektor: Leonora Fejzullahu - Ruhani.

Telefonat kontaktues: 038 5080 1243, 038 5080 1237, mob: 044 506 308, 044 181 418

E-mail: zimp@kosovopolice.com, info@kosovopolice.com.

www.kosovopolice.com, facebook.com/KosovoPolice

PËRMBAJTJA

FAQE 7-8

25 VJET SHËRBIM ME NDER DHE DINJITET

FAQE 14-15

SHËNOHET PËRVJETORI I PARË I RËNIES SË HEROIT AFRIM BUNJAKU



PIKË SHITESË:

Mendimet, komentet, këndvështrimet e shprehura ose të përfshira në përmbajtje të disa shkrimeve të këtij botimi nuk paraqesin medeomos qëndrimet ose vështrimet zyrtare të PK-së

NË KUADËR TË PARTNERITETIT DHE TË BASHKËPUNIMIT, AMBASADA BRITANIKE NË KOSOVË DHURON DONACION PËR POLICINË E KOSOVËS, 4

DREJTORI I CIA-SË, TAKOI DREJTORIN E PK-SË, 4

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË KOSOVËS, GAZMEND HOXHA DHE STAFI EKZEKUTIV, SHPREHËN MIRËNJOHJE NDAJ AMBASADORIT JEFFREY HOVENIER ME RASTIN E PENSIONIMIT TË TIJ, 4

KONFERENCA NDËRKOMBËTARE E SHEFAVE TË POLICISË (IACP), PJESËMARRJA E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË POLICISË SË KOSOVËS, 5

POLICIA E KOSOVËS PRANON DONACIONIN E RADHËS NGA AMBASADA GJERMANE, 6

POLICIA E KOSOVËS PËRFORCOHET ME AUTOMJETE TË BLINDUARA DHE TEKNOLOGJI TË REJA, 6

MARSHI DHE HIMNI ZYRTAR I POLICISË SË KOSOVËS, SIMBOL I VLERAVE DHE PËRKUSHTIMIT NË SHËRBIM TË VENDIT, 9

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË KOSOVËS HOXHA, TAKON TË NGARKUARIN ME PUNË ME AMBASADËN JAPONEZE Z. KEISUKE YAMANAKA, 10

MË 6 SHTATOR, DREJTORI I DD-ICITAP, GREGORY E. DUCOT, VIZITOI KOSOVËN, KU U PRIT NGA DREJTORI I PËRGJITHSHËM, HOXHA, 10

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË KOSOVËS, KOLONEL GAZMEND HOXHA, PRET NË TAKIM DREJTORIN E POLICISË SË SHTETIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, 10

KOSOVA NË TOP 15 VENDET MË TË SIGURTA NË BOTË: SUKSESI I POLICISË SË KOSOVËS NË GARANTIMIN E SIGURISË PUBLIKE, 11 STËRVITJE E PËRBASHKËT NË QENDRËN E NJËSIVE SPECIALE NË VRELLË, 12

PËRURORHET OBJEKTI I RI I STACIONIT POLICOR NË MAMUSHË, 13

SFIDAT DHE PËRKUSHTIMI I POLICISË SË KOSOVËS PËR SIGURINË E REPUBLIKËS SË KOSOVËS, 16

FORCIMI I BASHKËPUNIMIT NDËRMJET POLICISË SË KOSOVËS DHE RADIO TELEVISIONIT TË KOSOVËS, NËNSHKRUHET MARRËVESHJE MIRËKUPITIMI, 17

POLICIA E KOSOVËS THEMELON SHOQATËN SPORTIVE ME KLUBE NË DISIPLINA TË NDRYSHME, 17

RËNDËSIA E TRANSPARENCËS SË INSTITUCIONEVE NË RAPORT ME PUBLIKUN DHE QASJA NË INFORMATA NGA POLICIA E KOSOVËS, 18

OPERACIONET 19-21

BASHKËPUNIM I FRYTSHËM NDËRMJET SHËRBIMIT SPITALOR KLINIK DHE UNIVERSITAR TË KOSOVËS (SHSKUK) DHE POLICISË SË KOSOVËS (PK), 22

MBROJTJA E KUFIJVE NË KUSHTE DIMËRORE, 23

NDERIMI I ZYRTARËVE POLICORË TË RËNË NË KRYE TË DETYRËS PËRMES LOJËRAVE TRADICIONALE SPORTIVE, 24

ARKIVI QENDROR I POLICISË PREZANTOHET NË KONFERENCËN NDËRKOMBËTARE NË SLLOVENI, 25 - 26

FOTOLAJME, 27 -28

AKTIVITETE

PRISHTINË

NË KUADËR TË PARTNERITETIT DHE TË BASHKËPUNIMIT, AMBASADA BRITANIKE NË KOSOVË DHURON DONACION PËR POLICINË E KOSOVËS



Zëvendësdrejtori i Policisë së Republikës së Kosovës, z. Fehmi Hoti, dhe ambasadori britanik në Kosovë, z. Jonathan Hargreaves, nënshkruan marrëveshjen për pranim-dorëzimin e katër dronëve, një donacion i rëndësishëm për Policinë e Kosovës.

Dronët do të ndihmojnë njësitet policore në identifikimin, gjurmimin dhe monitorimin e automjeteve dhe personave të dyshimtë, duke përdorur imazhërinë dhe aftësitë termale. Këto pajisje do të rrisin efikasitetin dhe profesionalizmin e Policisë së Kosovës, veçanërisht në njësitet kufitare për parandalimin e krimit transkufitar, kontrabandës dhe migrimit të paligjshëm.

Policia e Kosovës falënderon Ambasadën Britanike për mbështetjen dhe përkrahjen e vazhdueshme, duke vënë këtë donacion në funksion të sigurisë dhe rendit publik.



DREJTORI I CIA-SË, TAKOI DREJTORIN E PK-SË

Më 22 gusht 2024, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, kolonel Gazmend HOXHA, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, priti në Shtabin e Policisë së Kosovës Drejtorin e Agjencisë Qendrore të Inteligjencës (CIA) të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, z. William Burns, i cili shoqërohej nga përfaqësues të Ambasadës së SHBA-së në Kosovë. Gjatë këtij takimi, drejtori Hoxha i njoftoi të pranishmit për situatën e sigurisë në Republikën e Kosovës, si dhe për përpjekjet dhe aktivitetet e Policisë së Kosovës në ruajtjen e rendit kushtetues dhe sigurisë publike në vend. Takimi përfundoi me z. Burns duke shprehur mirënjohje për punën, përkushtimin dhe profesionalizmin e Policisë së Kosovës, dhe të dyja palët shprehën përkushtimin e tyre për bashkëpunim të ndërsjellë në fushën e sigurisë dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, duke përfshirë mbështetjen në ofrimin e trajnimeve për Policinë e Kosovës.



DREJTORI I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË KOSOVËS, GAZMEND HOXHA DHE STAFI EKZEKUTIV, SHPREHËN MIRËNJOHJE NDAJ AMBASADORIT JEFFREY HOVENIER ME RASTIN E PENSIONIMIT TË TIJ

Drejtori i Përgjithshëm ia dorëzoi ambasadorit një flamur të palosur të Policisë së Kosovës, një certifikatë mirënjohjeje dhe një shenjë të Policisë së Kosovës me gravurën "Jeffrey Hovenier 007" për vitet e tij të kontributit dhe mbështetjes për Policinë. Në certifikatë thuhet: "Për nderim dhe mirënjohje të thellë për mbështetjen dhe asistencën tuaj të vazhdueshme ndaj Policisë së Kosovës, për përkushtimin tuaj të jashtëzakonshëm në zhvillimin dhe avancimin e shkathtësive të Policisë së Kosovës dhe për avokimin tuaj për sundimin e ligjit dhe parimeve demokratike, të cilat ne i konsiderojmë thelbësore për një agjenci policore të suksesshme. Policia e Kosovës angazhohet për vizionin tonë të përbashkët për një forcë policore shumë-etnike, plotësisht të integruar, që përfaqëson të gjithë qytetarët e Kosovës. Prania juaj fizike do të mungojë, por trashëgimia juaj do të mbetet përherë."



Konferenca Ndërkombëtare e Shefave të Policisë (IACP) Pjesëmarrja e drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës



Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës,
kolonel Gazmend Hoxha, u nderua me vulën DOJ

Në kuadër të angazhimeve ndërkombëtare për fuqizimin e bashkëpunimit, drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, kolonel Gazmend Hoxha, mori pjesë në Konferencën e Shefave të Policisë, (IACP) në San Diego, Kaliforni. Kjo konferencë është një nga ngjarjet më të rëndësishme globale në fushën e sigurisë, duke mbledhur përfaqësues të lartë nga policitë e vendeve të ndryshme të botës.

Pjesëmarrja e delegacionit nga Policia e Kosovës në këtë forum të nivelit të lartë në krye me kolonel Hoxhën, ishte një mundësi e jashtëzakonshme për shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira në fushën e sigurisë publike. Takimet dhe diskutimet u përqendruan në sfidat globale me të cilat përballen institucionet e sigurisë, si dhe në identifikimin e zgjidhjeve për fenomenet e reja, duke përfshirë luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe radikalizmit të dhunshëm. Gjatë agjendës së tij në kuadër të konferencës, drejtori i Përgjithshëm Hoxha realizoi takime me personalitete të ndryshme nga bota e sigurisë, ku u diskutuan çështje të rëndësishme si: luftimi i krimit transnacional, forcimi i mekanizmave të bashkëpunimit për zbulimin dhe parandalimin e krimeve kibernetike, implementimi i strategjive për forcimin e sigurisë ndërkombëtare dhe rajonale etj.

Pjesëmarrja e Policisë së Kosovës në këtë konferencë përfaqëson përkushtimin për të ndjekur standardet më të larta të profesionalizmit dhe për të forcuar bashkëpunimin me policitë dhe organizatat ndërkombëtare të sigurisë. Këto angazhime ndihmojnë në rritjen e efikasitetit të Policisë së Kosovës në luftën kundër krimit dhe në garantimin e një mjedisi më të sigurt për qytetarët.

Kjo konferencë i ka shërbyer Policisë së Kosovës për të krijuar lidhje të reja, për të ndarë përvoja dhe për të zhvilluar strategji dhe trajnime të përbashkëta në përballimin e sfidave globale në fushën e sigurisë në përgjithësi.

Në këtë konferencë, Drejtori i Përgjithshëm, Kolonel Gazmend Hoxha, u nderua me prezantimin e një vule të madhe të Departamentit të Drejtësisë të SHBA-së (DOJ) për partneritetin e tij dhe kontributin me vlerë, i cili çoi në njohjen e ICITAP-it në Kosovë si me numrin më të madh të "raporteve" të dorëzuara në seli, duke verifikuar punën e përkushtuar dhe të përbashkët, si dhe ndihmën e dhënë në fushën e sigurisë. Kjo vulë prestigjioze e DD u prezantua nga Drejtori i ICITAP-it, Gregory Ducot, gjatë takimit të nivelit të lartë ICITAP-DD, ku morën pjesë përfaqësues nga shumica e programeve globale të DD-ICITAP në konferencën vjetore të IACP.





Policia e Kosovës pranon donacionin e radhës nga Ambasada Gjermane

Policia e Kosovës, gjegjësisht Departamenti për Kufi, më 17.12.2024, në një ceremoni të organizuar, ka pranuar një donacion nga Gjermania, donacion i realizuar përmes Ambasadës Gjermane në Republikën e Kosovës.

Për të shënuar këtë donacion u realizua një ceremoni e dorëzimit-pranimit të mjeteve, ku dorëzimi i pajisjeve u bë nga ambasadori gjerman në vendin tonë z. Joern ROHDE, kurse pajisjet u pranuan nga drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës kolonel Gazmend HOXHA. Prezent në ceremoni ishte edhe ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme z. Xhelal SVEÇLA, drejtori i Departamentit për Kufi z. Fehmi XHATA etj.

Rreth bashkëpunimit dhe mbështetjes së ofruar nga Gjermania, të pranishmit mbajtën nga një fjalë rasti, ku nga ana jonë u falënderua shteti gjerman për mbështetjet të vazhdueshme për Policinë e Kosovë si në trajnime ashtu edhe në ofrim të pajisjeve për PK-në.

Policia e Kosovës përmes këtij donacioni pranoi:

- 10 vetura Dacia, vlera 19,880.00€
 - 10 Skaner për dokumente, vlera 23,000.00€
 - 1 set me 3 kamera te sigurisë Smart-dec, vlera 40,500.00€ dhe
 - 12 Kamera Termike, vlera 36,600.00€.
- Vlera e përgjithshme e pajisjeve të pranuar është 298,900.00 euro.



Policia e Kosovës përforcohet me automjete të blinduara dhe teknologji të reja

Policia e Kosovës (PK), në kuadër të planifikimeve afatgjate dhe objektivave të parapara strategjike, për ngritje të kapaciteteve të vazhdueshme të burimeve njerëzore dhe atyre logjistike e teknologjike, parasheh që përmes realizimit të trajnimeve policore, furnizimit me pajisje logjistike e teknologjike për njësi të ndryshme policore, të mundësohet kryerja e detyrave dhe autorizimeve policore në mënyrë sa më efektive dhe efektive në interes të qytetarëve dhe vendit.

Policia e Kosovës, që nga themelimi i saj e deri në këtë periudhë konform zhvillimeve dhe nevojave policore, ka planifikuar edhe furnizimin me pajisje policore, përfshirë furnizimin me automjete, të cilat shërbejnë si mjete bazë për përmbushjen misionit të PK-së.

Përveç furnizimit me automjete të rregullta patrulluese, Policia e Kosovës konform procedurave të parapara ligjore tani është furnizuar edhe me disa automjete policore të blinduara dhe disa autoblanda, të cilat shërbejnë për nevojat e Policisë së Kosovës.

Policia e Kosovës, po punon vazhdimisht në ngritje të kapaciteteve të burimeve njerëzore, logjistike e të teknologjisë, me qëllim që në mënyrë sa më profesionale të përmbushë me sukses misionin dhe vizionin e sajë në ofrimin e sigurisë dhe ruajtjes së rendit kushtetues.



25 VJET SHËRBIM ME NDER DHE DINJITET



Me 06.09.2024, me rastin e shënimit të 25 vjetorit të themelimit, Policia e Kosovës organizoi një ceremoni solemne, në të cilën morën pjesë personalitete të larta shtetërore dhe përfaqësues të agjencive të sigurisë nga rajoni dhe më gjerë, si dhe përfaqësues të institucioneve vendore e ndërkombëtare.

Pjesë e kësaj ceremonie ishin edhe eprorë të lartë të PK-së dhe familjarë të heronjve të Policisë së Kosovës që kanë rënë në krye të detyrës.

Këtë ceremoni, përveç pjesëmarrjes së mysafirëve, të cilët nderuan institucionin e PK-së me pjesëmarrjen e tyre, e karakterizoi edhe marshi dhe himni i Policisë së Kosovës, të cilat ekskluzivisht në këtë datë historike të 25 vjetorit u publikuan për herë të parë.

Me nga një fjalë rasti të pranishmëve gjatë kësaj ceremonie iu drejtuan presidentja e Republikës së Kosovës znj. Vjosa Osmani, kryeministri z. Albin Kurti, ministri i Punëve të Brendshme z. Xhelal Sfeqja dhe drejtori i Përgjithshëm i PK-së kolonel Gazmend Hoxha, të cilët gjatë fjalimeve të tyre kanë vlerësuar angazhimin e Policisë së Kosovës dhe gjithë pjesëtarëve të saj përgjatë gjithë kësaj periudhe kohore në ruajtjen e rendit publik dhe rendit Kushtetues, ofrimin e sigurisë ndaj qytetarëve, duke vazhduar më tej primatin si institucioni më i besueshëm dhe më transparent në Republikën e Kosovës.

Këtë ceremoni e madhështoi edhe trupa muzikore e organizuar nga Policia e Kosovës, të cilët interpretuan live himnin e PK-së, himnin shtetëror dhe marshin e PK-së, përfshirë interpretimin edhe të dy pikave artistike muzikore.

Gjatë kësaj ceremonie është prezantuar edhe dokumentari “25 vjet polici”, i cili është përgatitur enkas për këtë 25 vjetor.

Pas kësaj ceremonie në kampin Vrella, njësitë speciale elite të PK-së, përmes një ushtrimi kanë demonstruar shkathtësitë e tyre profesionale para pjesëmarrësve me rastin e këtij 25 vjetori, në të cilin morën pjesë edhe personalitetet e larta shtetërore.

Policia e Kosovës uron të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe pjesëtarët e saj me rastin e 25 vjetorit të PK-së me sloganin “25 vjet shërbim me nder dhe dinjitet”.





Policia e Kosovës, me rastin e 25-vjetorit të themelimit të saj, organizoi një seri aktivitesh që përfshinin projekte edukative, gara sportive dhe ceremoni përkujtimore, duke dëshmuar përkushtimin ndaj sigurisë publike dhe bashkëpunimit me qytetarët e vendit.

Në sheshin "Zahir Pajaziti" në Prishtinë, ceremonia qendrore mbledhi personalitete të larta shtetërore dhe drejtues të Policisë së Kosovës. Të pranishëm ishin Kryeministri Albin Kurti, Ministri i Punëve të Brendshme Xhelal Sveçla dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, Kolonel Gazmend Hoxha. Ngjarja u shoqërua nga takime mes fëmijëve të policëve të rënë në detyrë dhe njësisve të specializuara si Njësia K-9 dhe Njësia e Antidronëve, duke krijuar një lidhje mes brezave të rinj dhe trashëgimisë së institucionit.

Një iniciativë e veçantë ishte projekti "Sot unë polic i Kosovës", i cili u realizua në disa rajone të ndryshme në nivel vendi. Në kuadër të këtij projekti, fëmijët të veshur me uniforma policore bashkëpunuan me zyrtarë të Policisë, duke kryer ndalime simbolike të automjeteve dhe shpërndarë materiale edukative. Ky aktivitet i dha mundësinë të rinjve të përjetonin nga afër rolin dhe përgjegjësitë e një zyrtari policor, duke rritur ndërgjegjësimin për sigurinë në trafik dhe respektimin e ligjit.

Në kuadër të aktiviteteve të organizuara, janë mbajtur gjithashtu ushtrime taktike në Kampin Vrella nga njësitë më elitare të Policisë së Kosovës. Këto ushtrime demonstrojnë nivelin e lartë të profesionalizmit dhe gatishmërisë operacionale të këtyre njësisve, duke u fokusuar në skenarë kompleks të sigurisë dhe reagimit emergjent.

Për nder të përvjetorit, Policia e Kosovës organizoi gara sportive që përfshinin disiplina si futboll, voleybolli, atletika dhe qitja. Ndeshjet përfundimtare u mbajtën në stadione dhe salla sportive në mbarë vendin, ku pjesëmarrësit garuan me entuziazëm. Veçanërisht, përfshirja e policeve femra në aktivitete sportive si futboll dhe basketbolli theksoi përkushtimin e Policisë për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave në institucion.

Këto aktivitete kulmuan me një ndeshje miqësore në stadiumin "Ramiz Sadiku" në Prishtinë, ku u ballafaquan ekipet e Policisë së Kosovës dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës, duke simbolizuar unitetin dhe bashkëpunimin mes dy institucioneve kryesore të vendit.

Përmes këtyre aktiviteteve, Policia e Kosovës jo vetëm që festoi historinë dhe sukseset e saj, por gjithashtu riafirmoi angazhimin për të shërbyer me profesionalizëm dhe përkushtim ndaj qytetarëve dhe kombit. Ceremonia solemne e 6 shtatorit e cila kulmojë këtë përvjetor historik, duke mbetur si një testament i përkushtimit dhe vizionit të Policisë për të ardhmen.

Përgatiti:

Çajup Kajtazi,

Arlinda Rexhepi - Gërxhaliu,

Leonora Fejzullahu - Ruhani





Marshi dhe himni zyrtar i Policisë së Kosovës, simbol i vlerave dhe përkushtimit në shërbim të vendit

Policia e Kosovës gjatë këtij viti, përveç arritjeve tjera në fushën e zbatimit të rendit dhe ligjit, ka kurorëzuar një arritje tjetër të rëndësishme me miratimin zyrtar të marshit dhe himnit të saj me muzikë dhe tekst të himnit policor. Ky himn, si një krijim artistik dhe domethënës, pasqyron vlerat kryesore të këtij institucioni: disiplinën, ndjeshmërinë dhe profesionalizmin në shërbim të qytetarëve dhe mbrojtjes së rendit dhe sigurisë publike.

Himni zyrtar i Policisë së Kosovës do të jetë një element tjetër i rëndësishëm i identitetit institucional dhe do të përdoret në aktivitete të shumta, duke përfshirë ceremonitë zyrtare, parakalimet, ngjarjet e rëndësishme shtetërore dhe aktivitete të veçanta që përfshijnë Policinë e Kosovës. Përmes melodisë dhe fjalëve të tij, himni synon të ngjallë ndjenjën e krenarisë, përkushtimit dhe solidaritetit, jo vetëm në mes të pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, por edhe në komunitetin e gjerë.

Ky himn është fryt i një procesi të gjatë dhe të kujdesshëm krijues, i cili ka përfshirë artistë dhe profesionistë të njohur, si dhe një vlerësim të hollësishëm për të garantuar që teksti dhe muzika reflektojnë në mënyrë autentike misionin dhe vizionin e Policisë së Kosovës.

Himni jo vetëm që nderon punën dhe sakrificat e pjesëtarëve të Policisë, por gjithashtu dërgon një mesazh të qartë të përkushtimit ndaj ligjit dhe sigurisë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Ai përfaqëson një simbol të fuqishëm të unitetit, përkushtimit dhe guximit, duke forcuar rolin e Policisë së Kosovës si një garantues i paqes dhe stabilitetit.

Duke i dhënë jehonë një qëllimi të përbashkët, himni përforcon lidhjen në mes të Policisë së Kosovës dhe qytetarëve të saj, duke përkujtuar se misioni për rend dhe drejtësi është një mision i përbashkët për të mirën e vendit.

Ky himn është prezantuar për herë të parë në ceremoninë e 25-vjetorit të themelimit të Policisë së Kosovës dhe përfaqëson me krenari shpirtin e shërbimit dhe përkushtimit ndaj vendit, si dhe do ta përcjellë Policinë e shtetit ndër gjenerata si simbol që do të frymëzojë breza të tërë në shërbim të atdheut.

Ky është himni zyrtar i Policisë së Republikës së Kosovës, një simbol i krenarisë, përkushtimit dhe solidaritetit që përfaqëson vlerat dhe misionin e institucionit në shërbim të shtetit dhe qytetarëve.



**Rreze drite rreth kurorës
Në çdo pëllëmb' të vendit tim
Policia e Kosovës
Ditë e natë në shërbim**

**Me guxim e me plot zemër
Ëndrra, pronë, ideale mbroj
Ballellart me këtë emër
Fali frymë, jeta t'lulëzoj'**

Refreni:

**Jeta, shpresa e siguria
Nderi, ligji janë betim
Se unë jam policia
Jam emblemë e shtetit tim**



DREJTORI I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË KOSOVËS HOXHA, TAKON TË NGARKUARIN ME PUNË ME AMBASADËN JAPONEZE Z. KEISUKE YAMANAKA

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës Kolonel HOXHA me bashkëpunëtorë priti në një takim mikpritës të ngarkuarin me punë në Ambasadën Japoneze z. Keisuke YAMANAKA. Gjatë takimit, u diskutua për situatën e sigurisë në vend, bashkëpunimin dhe raportet reciproke në funksion të sigurisë së përgjithshme si dhe mundësinë e përkrahjes dhe mbështetjes nga shteti japonez. Drejtori Hoxha shprehu mirënjohjen e tij për mbështetjen që Japonia i ofron Policisë së Kosovës, me këtë rast u konfirmua se ky bashkëpunim është dëshmi e përkushtimit dypalësh dhe do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

MË 6 SHTATOR, DREJTORI I DD-ICITAP, GREGORY E. DUCOT, VIZITOI KOSOVËN, KU U PRIT NGA DREJTORI I PËRGJITHSHËM, HOXHA

Më 6 shtator, drejtori i DD-ICITAP, Gregory E. Ducot, vizitoi Kosovën, ku u prit nga Drejtori i Përgjithshëm, Kolonel Hoxha, dhe mori pjesë në shënimin e 25-vjetorit të Policisë së Kosovës (PK) në Prishtinë.

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Kolonel Hoxha, i dhuroi drejtorit të ICITAP, Gregory Ducot, një pllakë me mbishkrimin: "Për partneritetin dhe bashkëpunimin tuaj në rrugën tonë të përbashkët."

Hoxha e falënderoi drejtorin Ducot për mbështetjen dhe ndihmën e vazhdueshme ndër dekada, ndërsa drejtori Ducot vlerësoi avancimin e agjencisë.



DREJTORI I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË KOSOVËS, KOLONEL GAZMEND HOXHA, PRET NË TAKIM DREJTORIN E POLICISË SË SHQIPËRISË

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, kolonel Gazmend Hoxha, i shoqëruar nga stafi i lartë i tij, sot ka pritur në takim miqësor drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shqipërisë z. Ilir Proda, po ashtu i shoqëruar edhe nga zyrtarë të lartë policorë të shtetit.

Në takimin i cili u realizua në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të PK-së, drejtori Hoxha fillimisht ka falënderuar drejtorin Proda për vizitën e tij dhe njëkohësisht ia ka uruar të njëjtit detyrën e tij në krye të Policisë së Shtetit.

Drejtori Hoxha i njoftoi të pranishmit mbi angazhimet, aktivitetet dhe objektivat e Policisë së Kosovës, si dhe përkushtimin e vazhdueshëm në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve të saja ligjore në të mirë të sigurisë dhe rendit kushtetues në Republikën e Kosovës.

Përveç tjerash të pranishmit u njoftuan se Policia e Kosovës ka kapacitete profesionale dhe është e përgatitur që të ofrojë siguri, të luftojë kundër krimit të organizuar si dhe të bashkëpunojë ngushtë me organizatat policore, me qëllim të avancimit të mëtejshëm të bashkëpunimit të ndërsjellë në fushën e sigurisë dhe parandalimit të terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.


Gjithashtu është veçuar se Policia e Kosovës ka bashkëpunim të shkëlqyer me autoritetet policore të Shqipërisë, bashkëpunim ky i cili ka treguar rezultate pozitive në fusha të ndryshme, duke përfshirë edhe sukseset në patrullimet e përbashkëta policore dhe luftën ndaj dukurive negative.

Në anën tjetër, drejtori Proda falënderoi drejtorin Hoxha për mikpritjen dhe njëherit potencoi se Policia e Shqipërisë do të jetë çdo herë e gatshme në realizimin e synimeve të të dy policive, si në fushën e trajnimeve po ashtu edhe të luftës ndaj krimit, përfshirë atë transkufitar.

Takimi u përmbyll me zotimin e dy përfaqësuesve kryesorë të dy institucioneve simotra, për rritje të mëtejshme të bashkëpunimit në të ardhmen, duke u zgjeruar edhe në fusha të reja me interes të përbashkët.



KOSOVA NË TOP 15 VENDET MË TË SIGURTA NË BOTË: SUKSESI I POLICISË SË KOSOVËS NË GARANTIMIN E SIGURISË PUBLIKE



Renditja e Kosovës si vendi i 12-të më i sigurtë në botë është një dëshmi e përkushtimit të Policisë së Kosovës dhe bashkëpunimit të fuqishëm me qytetarët për të ndërtuar një shoqëri të sigurt dhe të qëndrueshme

Kosova është renditur si vendi i 12-të më i sigurtë në botë sipas raportit të Gallup-it për 2023, një arritje e rëndësishme që reflekton punën e Policisë së Kosovës dhe bashkëpunimin me qytetarët dhe institucionet shtetërore. Ky sukses tregon përparimin në siguri dhe besimin e qytetarëve në institucionet shtetërore.

Falë punës së palodhshme dhe angazhimit profesional të Policisë së Kosovës, si dhe bashkëpunimit të ngushtë me qytetarët dhe institucionet tjera shtetërore, Republika e Kosovës ka arritur suksese të shënuara në fushën e sigurisë publike. Një nga arritjet më të spikatura në këtë drejtim është renditja e Kosovës si vendi i 12-të më i sigurtë në botë, sipas raportit të Gallup-it mbi sigurinë globale për vitin e kaluar (2023).

Sipas këtij raporti, qytetarët e Kosovës ndihen të sigurtë duke ecur vetëm në rrugë gjatë natës. Ky është një tregues i qartë i progresit në sektorin e sigurisë, i cili përveç policisë, reflekton edhe besimin e qytetarëve në institucionet shtetërore dhe fuqinë e bashkëpunimit ndër-institucional. Kosova renditet krahas vendëve si Norvegjia, Zvicra dhe Singapori, duke treguar se siguria publike në vend ka arritur nivele që krahasohen me ato të vendeve të zhvilluara ekonomikisht dhe me sundim të fuqishëm të ligjit.

Policia e Kosovës ka luajtur një rol vendimtar në arritjen e këtyre rezultateve pozitive. Me anë të strategjive të mirë-planifikuara, patrullimeve të vazhdueshme, dhe angazhimit profesional të stafit të saj, Policia e Kosovës ka forcuar sigurinë dhe ka parandaluar veprimtaritë kriminale. Kjo ka rezultuar në ulje të kriminalitetit dhe krijimin e një ambienti të qetë për të gjithë qytetarët. Një aspekt tjetër që ka kontribuar në suksesin e Policisë së Kosovës është bashkëpunimi i ngushtë me qytetarët. Fushatat sensibilizuese, komunikimi i hapur dhe shërbimet e ofruara me profesionalizëm kanë ndihmuar në

krijimin e një besimi të ndërsjellë, duke nxitur qytetarët të raportojnë rastet kriminale dhe të bashkëpunojnë në parandalimin e tyre. Policia e Kosovës nuk ka arritur këto rezultate e vetme. Një rol thelbësor në suksesin e saj ka pasur bashkëpunimi me institucionet shtetërore, si dhe partnerët strategjikë në nivel vendor dhe ndërkombëtar. Ky bashkëpunim ka mundësuar koordinimin e veprimeve dhe forcimin e masave të sigurisë. Policia e Kosovës mbetet e përkushtuar për të vazhduar punën e saj me profesionalizëm dhe përkushtim të plotë. Me anë të investimeve në teknologji të avancuar, trajnimeve të vazhdueshme dhe forcimit të bashkëpunimit me qytetarët, Policia synon të mbajë dhe të përmirësojë më tej nivelin e sigurisë në vend. Suksesi i arritur në fushën e sigurisë nuk do të ishte i mundur pa mbështetjen dhe bashkëpunimin e qytetarëve. Policia e Kosovës shpreh mirënjohjen e saj për qytetarët, të cilët kanë qenë partnerë kyç në krijimin e një ambienti të sigurt dhe të qetë.

Raporti i Gallup-it është një dëshmi e fuqishme e përparimeve të mëdha që Kosova ka bërë në fushën e sigurisë publike. Këto arritje janë rezultat i punës së palodhshme të Policisë së Kosovës, bashkëpunimit ndër-institucional dhe mbështetjes së vazhdueshme nga qytetarët. E ardhmja e sigurisë në Kosovë duket premtuese, dhe angazhimi i vazhdueshëm i Policisë së Kosovës dhe menaxhmentit të saj profesional garanton që ky trend pozitiv do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

STËRVITJE E PËRBASHKËT NË QENDRËN E NJËSIVE SPECIALE NË VRELLË



Më 25 nëntor 2024, Policia e Kosovës, EULEX-i dhe KFOR-i, realizuan një trajnim të përbashkët në Kampin e Njësive Speciale në Vrellë. Ky trajnim kishte për qëllim forcimin e bashkëpunimit, ndërveprimit dhe gatishmërisë operacionale për të përballuar sfidat e sigurisë dhe emergjencave.

Në këtë aktivitet, pjesëmarrësit demonstuan profesionalizëm të lartë dhe angazhim të palëkundur për garantimin e sigurisë dhe stabilitetit në Republikën e Kosovës.

Për ta përcjellë nga afër këtë ushtrim në Kampin Vrella ishin prezentë: drejtori Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, kolonel Gazmend Hoxha, shefi i EULEX-it, Giovanni Pietro Barbano dhe komandanti i KFOR-it, gjeneral Enrico Barduani.

Ky bashkëpunim i vazhdueshëm ndërmjet institucioneve vendore dhe ndërkombëtare është një dëshmi e përkushtimit tonë të përbashkët për një të ardhme më të sigurt për të gjithë qytetarët e vendit.





PËRURIMET OBJEKTI I RI I STACIONIT POLICOR NË MAMUSHË

Më 11 dhjetor 2024, në një ceremoni solemne u përurua objekti i ri i Stacionit Policor në Komunën e Mamushës. Ky investim përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt forcimit të kapaciteteve të Policisë së Kosovës dhe përmirësimit të sigurisë për banorët e kësaj komune.

Në këtë ngjarje të rëndësishme morën pjesë personalitete të larta, përfshirë ministrin e Zhvillimit Rajonal, z. Damka, drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, kolonel Hoxha, kryetarin e Komunës së Mamushës, z. Krasniq, drejtues të Drejtorisë Rajonale të Policisë Prizren, eprorë dhe zyrtarë të tjerë policorë, si dhe përfaqësues nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare.

Ceremonia e përurimit u drejtua nga ministri Damka, drejtori i Përgjithshëm kolonel Hoxha, drejtori i Drejtorisë Rajonale Prizren, dhe kryetari i Komunës së Mamushës, të cilët nënvizuan rëndësinë e këtij projekti për komunitetin lokal.

Në shenjë mirënjohjeje për angazhimin dhe mbështetjen gjatë realizimit të projektit, kolonel Hoxha ndau çmime mirënjohjeje për kryetarin e Komunës, z. Krasniq, komandantin e Stacionit Policor në Mamushë, toger Orqusha, si dhe për mbikëqyrësen e projektit, znj. Latifi.

Objekti i ri është projektuar dhe ndërtuar për të ofruar kushte më të mira pune për zyrtarët policorë, duke forcuar kështu aftësinë e Policisë së Kosovës për të siguruar rendin dhe sigurinë në këtë rajon. Për më tepër, ky investim garanton një shërbim më të shpejtë, efikas dhe të përshtatur ndaj nevojave të banorëve të Mamushës.

Ky përurim përfaqëson jo vetëm një arritje për Policinë e Kosovës, por edhe një tregues të përkushtimit të institucioneve për të investuar në mirëqenien dhe sigurinë e qytetarëve.



**OBJEKTI I RI
STACIONIT POLICOR NË
MAMUSHË ËSHTË NJË
HAP I RËNDËSISHËM
DREJT FORCIMIT TË
SIGURISË DHE OFRIMIT
TË SHËRBIMEVE MË
EFIKASE PËR
QYTETARËT**



SHËNOHET PËRVJETORI I PARË I RËNIES SË HEROIT AFRIM BUNJAKU



Më 24 shtator 2024, me rastin e njëvjetorit të rënies në krye të detyrës të rreshterit Afrim BUNJAKU, heroit më të ri të Republikës së Kosovës, personalitete të larta shtetërore dhe menaxhmenti i Policisë së Kosovës organizuan një sërë aktivitete të përkujtimeve në nderim të tij.

Aktivitetet nisën me vizitën tek familjarët e heroit, ku përfaqësues të institucioneve dhe të Policisë së Kosovës shprehën mirënjohjen e përjetshme për sakrificën dhe kontributin e jashtëzakonshëm të rreshterit Bunjaku. Më pas, u bënë homazhe pranë varrit të tij, ku personalitete të larta shtetërore, menaxhmenti policor, ambasadorë dhe përfaqësues të institucioneve vendore e ndërkombëtare vendosën kurora me lule, duke nderuar atë për veprën e tij heroike.

Në vazhdim, u vizitua edhe vendi i rënies së tij në fshatin Banjskë të Zveçanit, ku u zbulua tabela e rrugës që tani do të mbajë emrin e tij, "Afrim Bunjaku", si simbol i përjetësimit të sakrificës së tij për ruajtjen e sovranitetit dhe rendit kushtetues të Republikës së Kosovës.

Përvjetori kulmoi me një akademi përkujtimore të mbajtur në Prishtinë, ku Kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Albin Kurti, Ministri i Punëve të Brendshme, z. Xhelal Sveçla, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Kolonel Gazmend Hoxha, si dhe familjarë dhe kolegë të heroit mbajtën fjalime emocionuese, duke shprehur dhembjen e thellë, krenarinë dhe nderimin për jetën dhe veprën e rreshterit Bunjaku.



Secili nga personalitetet e pranishëm shprehu dhembjen, krenarinë dhe konsideratën më të lartë për sakrificën e heroit Bunjaku, në mbrojtje të sovranitetit dhe rendit kushtetues të Republikës së Kosovës



Heroi Afrim Bunjaku

Rreshteri Afrim (Ramadan) BUNJAKU, i lindur më 15 prill 1973 në fshatin Samadrexhë të Vushtrrisë, ishte një shembull i përkushtimit dhe profesionalizmit në Policinë e Kosovës. Pas përfundimit të arsimit të mesëm dhe specializimeve profesionale, ai iu bashkua Policisë së Kosovës më 12 mars 2001, duke u bërë pjesë e gjeneratës së 15-të të policisë. Me përkushtim të palëkundur, ai shërbeu në njësi të ndryshme policore, duke lënë gjurmë të pashlyeshme.

Karriera e tij ishte e mbushur me suksese dhe kontribut të vazhdueshëm:

Në vitin 2005-2007 shërbeu si instruktor në Akademinë Policore.

Në maj 2007 u gradua rreshter, duke udhëhequr njësi të ndryshme në rajonin e Mitrovicës me profesionalizëm dhe përkushtim të jashtëzakonshëm.

Në janar 2023 u sistemua në Drejtorinë Rajonale Mitrovicë Veri, ku punoi deri në rënien e tij heroike më 24 shtator 2023.

Gjatë karrierës së tij, rreshteri Bunjaku u shpërblye me një sërë mirënjohjesh, medaljesh dhe lëvdatash për profesionalizmin dhe devotshmërinë e tij. Përkushtimi i tij u vlerësua me çmime si "Medalja për Shërbim të Besnikërisë" për 10 dhe 20 vite shërbim të devotshëm në Policinë e Kosovës, si dhe mirënjohje të shumta nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë dhe institucione të tjera.

Afrim Bunjaku mbetet një shembull i guximit dhe sakrificës së pashoq, duke frymëzuar brezat e ardhshëm të Policisë së Kosovës dhe të gjithë qytetarët e vendit për përkushtimin ndaj atdheut dhe mbrojtjen e tij deri në fund.

Lavdi e përhershme heroit të Kosovës, Afrim Bunjaku!



SFIDAT DHE PËRKUSHTIMI I POLICISË SË KOSOVËS PËR SIGURINË E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Gjatë periudhës së fundit, Republika e Kosovës dhe qytetarët e saj janë përballur me sfida serioze të sigurisë të shkaktuara nga individë dhe grupe kriminale e terroriste. Këto grupe, përmes veprimeve të dhunshme dhe përdorimit të mjeteve shpërthyes, posaçërisht në veriun e vendit, kanë synuar të kërcënojnë sigurinë, të destabilizojnë rendin juridik dhe të pengojnë funksionimin normal të institucioneve legjitime të vendit.

Vetëm në gjysmën e dytë të vitit 2024, janë evidentuar 10 raste të sulmeve me mjete shpërthyes në komunat me shumicë serbe në veri të vendit. Objektiv i këtyre sulmeve kanë qenë qytetarët e Republikës së Kosovës, pa dallim etnie, prona e tyre, institucionet legjitime dhe infrastruktura kritike e Republikës së Kosovës. Këto akte përbëjnë jo vetëm kërcënim fizik dhe material, por edhe një përpjekje për të minuar paqen dhe sigurinë ndërmjet komuniteteve, që është një prej shtyllave të rëndësishme të stabilitetit të vendit tonë.

Policia e Kosovës, si mbrojtëse e rendit dhe ligjit, ka intensifikuar përpjekjet për të përballuar dhe për të neutralizuar këto kërcënime. Njësitë policore të rendit publik dhe ekipet tjera relevante, kanë rritur praninë në terren, duke përforcuar masat parandaluese dhe mbrojtëse, duke ndërmarrë veprime për kapjen e autorëve të këtyre sulmeve. Ndërkohë, bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare dhe partnerët tjerë strategjikë mbetet një element primar në këtë përpjekje.

Në përputhje me misionin e Policisë së Kosovës, mbështetja për të gjitha komunitetet dhe ruajtja e paqes ndërmjet tyre mbetet një prioritet i veçantë. Përmes takimeve të rregullta me përfaqësuesit lokalë dhe organizatave të shoqërisë civile, Policia e Kosovës synon të ndërtojë ura të forta të bashkëpunimit dhe të garantojë që secili qytetar të ndjehet i mbrojtur dhe i sigurt. Në bashkëpunim me institucionet shtetërore në vazhdimësi janë ndërmarrë masa për të forcuar mbrojtjen e infrastrukturës kritike, veprime aktive dhe sisteme të mbikëqyrjes janë duke u aplikuar për të parandaluar sulme të mëtejshme dhe për të garantuar një reagim më të shpejtë dhe efikas.

Përkushtimi i Policisë për ruajtjen e sigurisë dhe rendit juridik është i palëkundur. Policia e Kosovës do të vazhdojë të jetë në shërbim të qytetarëve dhe do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar një të ardhme të sigurt për të gjithë.

Përgatiti: Daut HOXHA



FORCIMI I BASHKËPUNIMIT NDËRMJET POLICISË SË KOSOVËS DHE RADIO TELEVISIONIT TË KOSOVËS, NËNSHKRUHET MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI

Në kuadër të përpjekjeve për të forcuar transparencën dhe komunikimin me publikun, Policia e Kosovës dhe Radio Televizioni i Kosovës (RTK), kanë nënshkruar një Marrëveshje Mirëkuptimi për bashkëpunim reciprok. Kjo marrëveshje ka për qëllim ngritjen dhe fuqizimin e partneritetit ndërmjet dy institucioneve, duke synuar informimin objektiv, të saktë dhe profesional të qytetarëve përmes mediave publike.

Sigurimi i informacionit të qartë, me kohë dhe të verifikuar për publikun lidhur me aktivitetet dhe operacionet e Policisë së Kosovës bëhet për të rritur transparencën. Po ashtu, informimi dhe edukimi i qytetarëve përmes përmbajtjeve që lidhen me rendin, sigurinë dhe çështje të tjera ka rëndësi shumë të madhe. Ndërtimi i mekanizmave të qëndrueshëm të komunikimit ndërmjet Policisë së Kosovës dhe mediave për menaxhimin e informacioneve në situata të zakonshme dhe emergjente përbën nevojë imediate për fuqizim të komunikimit.

Ky bashkëpunim me RTK-në përfaqëson një angazhim të ndërsjellë, për të përmirësuar informimin publik dhe për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve mbi përpjekjet e vazhdueshme të Policisë së Kosovës për garantimin e sigurisë dhe rendit publik. Përmes RTK-së, publiku do të ketë qasje në informacion të besueshëm dhe të detajuar, duke përfshirë raportime mbi operacionet policore dhe fushatat për sigurinë në komunitet.



Policia e Kosovës dhe RTK-ja e shohin këtë marrëveshje si një hap të rëndësishëm drejt ndërtimit të besimit dhe rritjes së përgjegjshmërisë institucionale, duke kontribuar kështu në forcimin e lidhjes me qytetarët.

Kjo iniciativë le të shërbejë si një model i mirë i bashkëpunimit ndër-institucional dhe mbetemi të hapur që iniciativa të tilla të përcillen edhe nga institucione tjera në vazhden e përpjekjeve tona, për të ndërtuar një shoqëri më të informuar dhe më të sigurt.

POLICIA E KOSOVËS THEMELON SHOQATËN SPORTIVE ME KLUBE NË DISIPLINA TË NDRYSHME



Me iniciativë të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, kolonel Gazmend Hoxha, dhe me aprovimin e ministrit të MPB-së, është themeluar Shoqata Sportive e Policisë së Kosovës (SHSPK), e cila do të themelojë klube sportive në disiplina të ndryshme.

Në kuvendin themelues të SHSPK-së, në bashkëpunim me kryesin e SHSPK, janë ndarë detyra dhe përgjegjësi për të gjitha disiplinat sportive.

Ky është një shembull konkret i përpjekjeve të Policisë së Kosovës për të avancuar jo vetëm në aspektin profesional, për ruajtjen e rendit dhe ligjit, por edhe në përpjekjet për të fuqizuar lidhjen në mes të shëndetit fizik dhe mental të pjesëtarëve të saj, si në aspektin social, human dhe sportiv.

Në këto përpjekje deri me datën 12.11.2024, janë themeluar gjithsej tetë (8) klube sportive në këto disiplina:

1. Futboll/futsall, i regjistruar në Komunën e Prishtinës,
2. Karate, i regjistruar në Komunën e Prishtinës dhe në Federatën e Karatesë së Kosovës,
3. Volejboll, i regjistruar në Komunën e Ferizajt,
4. Xhudo, në proces të regjistrimit në MPB,
5. Shah, i regjistruar në Komunën e Mitrovicës/Jug,
6. Shenjëtari/qitje, i regjistruar në Komunën e Vushtrrisë,
7. Atletikë, në proces të regjistrimit në Komunën e Prishtinës dhe
8. Basketboll, në proces të regjistrimit në Komunën e Prishtinës. Bazuar në statutin e klubeve të lartpërmendura, të drejtën e përfaqësimit në këto klube e kanë të gjithë pjesëtarët e PK-së, stafi civil i punësuar në PK dhe familjarët e tyre.

RËNDËSIA E TRANSPARENCËS SË INSTITUCIONEVE NË RAPORT ME PUBLIKUN DHE QASJA NË INFORMATA NGA POLICIA E KOSOVËS

Në një shoqëri demokratike, qytetarët kanë nevojë për institucione të hapura dhe të përgjegjshme. Prandaj, Policia e Kosovës mbetet e përkushtuar për të zbatuar politikatat dhe praktikatat që promovojnë transparencën dhe për të ruajtur një bashkëpunim të ngushtë me qytetarët, mediat dhe organizatat e tjera relevante.



*Përgatiti;
Daut HOXHA*

Transparenca është një nga parimet kryesore që ndikon shumë në rritjen e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve publike. Në këtë kontekst, Policia e Kosovës, si një ndër institucionet më të rëndësishme për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike, ka një rol të pazëvendësueshëm në sigurimin e qasjes në informata dhe respektimin e të drejtës së qytetarëve për t'u informuar.

Në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin Nr. 06/L-081 për qasje në dokumente publike, Policia e Kosovës angazhohet për të ofruar informata të qarta, të sakta dhe në kohë për qytetarët, duke respektuar standardet e transparencës dhe llogaridhënies. Ky angazhim përbën jo vetëm një obligim ligjor, por edhe një përgjegjësi morale për të forcuar besimin e ndërsjellë ndërmjet qytetarëve dhe Policisë.

Qasja në informata dhe dokumente publike

E drejta për qasje në dokumente publike është një e drejtë fundamentale e njeriut, e cila siguron pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në proceset demokratike. Policia e Kosovës, duke u mbështetur në dispozitat ligjore, ka ndërtuar procedura dhe mekanizma të qartë për trajtimin e kërkesave për informata dhe qasje në dokumente publike.

Në këtë drejtim, çdo qytetar, pa diskriminim, ka të drejtë të kërkojë informata që lidhen me aktivitetet dhe shërbimet policore. Përmes zyrtarit kompetent për qasje në dokumente publike, Policia e Kosovës garanton që kërkesat për informata të trajtohen në mënyrë efikase dhe të përgjegjshme, duke respektuar kufizimet ligjore që lidhen me mbrojtjen e të dhënave personale, sekretin shtetëror dhe sigurinë publike.

Për të lehtësuar këtë proces, Policia e Kosovës ka zhvilluar platforma digjitale dhe mekanizma të tjerë modernë që iu mundësojnë qytetarëve dhe mediave të kenë qasje më të shpejtë dhe më të lehtë në informata edhe përmes internetit. Për më tepër, raportet periodike, dokumentet strategjike, udhëzimet dhe dokumente tjera, publikohen në mënyre proaktive nëpër platformat digjitale të Policisë, respektivisht në webfaqen zyrtare dhe media sociale, si mjete të rëndësishme që përdoren për të mbajtur qytetarët të informuar për zhvillimet dhe aktivitetet e ndryshme policore.

Sigurimi i transparencës nuk është vetëm një detyrë e përditshme për Policinë e Kosovës, por një element thelbësor që forcon lidhjen ndërmjet institucioneve dhe qytetarëve. Duke ofruar informata të sakta dhe të qasshme, Policia e Kosovës jo vetëm që kontribuon në përmirësimin e shërbimeve policore, por edhe në ngritjen e standardeve demokratike të qeverisjes në vend.

Në një shoqëri demokratike, qytetarët kanë nevojë për institucione të hapura dhe të përgjegjshme. Prandaj, Policia e Kosovës mbetet e përkushtuar për të zbatuar politikatat dhe praktikatat që promovojnë transparencën dhe për të ruajtur një bashkëpunim të ngushtë me qytetarët, mediat dhe organizatat e tjera relevante.

Në përputhje me vizionin e saj për të qenë një institucion profesional dhe transparent, Policia e Kosovës vazhdon të jetë shembull i mirë i përkushtimit ndaj transparencës dhe qasjes në informata. Kjo qasje jo vetëm që kontribuon në forcimin e besimit publik, por gjithashtu ndihmon në avancimin e misionit të saj për të garantuar sigurinë dhe drejtësinë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.



KOSOVË, 2024

POLICE

OPERACIONE SPECIALE

TOP OPERACIONET

1

SULME TERRORISTE NË VERI TË KOSOVËS: POLICIA SEKUESTRON ARMATIM DHE MJETE SHPËRTHYESE

Në gjashtëmuorin e fundit, Institucionet e Kosovës janë shpërnduar nga sulme terroriste, të cilat kanë rrezikuar seriozisht sigurinë dhe rendin në vend. Vetëm në periudhën Qershor - Nëntor 2024, janë regjistruar 10 sulme me mjete shpërthyes, kryesisht në komunat me shumicë serbe, duke përfshirë sulme ndaj qytetarëve, institucioneve dhe infrastrukturës kritike të Kosovës.

2

POLICIA E KOSOVËS, PAS RAPORTIMEVE TË INSTITUCIONEVE MONITORUESE FINANCIARE...


Policia e Kosovës, pas raportimeve të institucioneve monitoruese financiare, si Njësia e Inteligjencës Financiare dhe Banka Qendrore e Kosovës



Policia e Kosovës më 03.11.2024 ka realizuar një operacion policor të koduar "Kalaja" i cili është realizuar në një qendër tregtare në rr. Magjistrale Pejë-Deçan, i cili ka rezultuar me arrestimin e dy personave të dyshuar shtetas të RKS-së. Pas kryerjes së arrestimeve është vazhduar me bastisje ku janë gjetur rreth 100 kilogramë substancë e dyshuar narkotike e llojit marihuanë, sasi kjo në gjendje të ndryshme, disa prej tyre e gatshme dhe të tjerat në formë të bimëve duke u terur e cila është sekuestruar. Bimët kanë qenë të kultivuara në afërsi të një shtëpie dhe sasia e tyre ishte 213 bimë, po ashtu operacionin policor ka vazhduar me bastisje edhe në fshatin Barilevë të Prishtinës, ku është gjetur një sasi e vogël si substancë e dyshuar narkotike. Në vendin e ngjarjes kanë dalë prokurori kompetent, si dhe Forenzika dhe rasti mbetet të hetohet nga njësitet kompetente të antidrogës dhe prokuroria kompetente.

Sulme terroriste në veri të Kosovës: Policia sekuestron armatim dhe mjete shpërthyes

Në gjashtëmuorin e fundit, institucionet e Kosovës janë sfiduar nga sulme terroriste, të cilat kanë rrezikuar seriozisht sigurinë dhe rendin në vend. Vetëm në periudhën qershor - nëntor 2024, janë regjistruar 10 sulme me mjete shpërthyes, kryesisht në komunat me shumicë serbe, duke përfshirë sulme ndaj qytetarëve, institucioneve dhe infrastrukturës kritike të Kosovës. Një nga sulmet më të rënda ka ndodhur më 29.11.2024, kur një sulm terrorist ka goditur infrastrukturën e furnizimit me ujë dhe energji në fshatin Varage, Zubin Potok, duke shkaktuar dëme të mëdha dhe duke rrezikuar furnizimin me ujë dhe energji për shumë zona. Policia e Kosovës, në bashkëpunim me Prokurorinë Speciale, ka ndërmarë operacione masive për arrestimin e të dyshuarve, duke realizuar kontrole në 10 lokacione dhe duke arrestuar tetë persona të dyshuar për sulme terroriste. Si rezultat, janë sekuestruar armë të rrezikshme, si raketahedhës dore, granata, armë automatike, municion, dhe prova të tjera që lidhen me këto akte dhune. Policia fton qytetarët të bashkëpunojnë në ofrimin e informacioneve për parandalimin e krimeve dhe sigurimin e rendit në Republikën e Kosovës.



Policia e Kosovës në vazhdën e luftës kundër veprimtarive kriminale, në koordinim me Prokurorinë Themelore Prizren, me datën 31.10.2024 ka realizuar një operacion të gjerë policor në Prizren dhe në Suharekë, i cili ka qenë i shtrirë në 6 lokacione të ndryshme, në të cilin janë arrestuar 6 persona të dyshuar për përfshirje në veprat penale të 'fajdesë' dhe 'detyrimit'. Gjatë zbatimit të operacionit policor, është realizuar urdhër-kontrolli i gjykatës, ku në vendbanimet e personave të dyshuar janë sekuestruar: 20 njësi banesore dhe lokale afariste, 5 automjete, 5 armë dhe municion të kalibrit të ndryshëm, dokumentacione, si: kontrata, para-kontrata, para të gatshme, prova digjitale, si dhe janë bllokuar llogaritë bankare të personave të dyshuar. Të dyshuarit kanë arritur të përfitojnë në mënyrë të kundërligjshme nga viktima shuma të mëdha të parave si dhe prona të paluajtshme dhe të luajtshme si formë e interesit nga veprimtaria e fajdesë, vlera e të cilave kalon shumë mbi 1 milion euro. Lidhur me rastin personat e dyshuar me aktvendim të prokurorit janë ndaluar për 48 orë.

Policia e Kosovës, pas raportimeve të institucioneve monitoruese financiare, si Njësia e Inteligjencës Financiare dhe Banka Qendrore e Kosovës, së bashku me Administratën Tatimore të Kosovës, bazuar në autorizim të prokurorit kompetent, ka zhvilluar një operacion policor në gjashtë lokacione të katër komunave në veri të Kosovës, e që janë: i ashtuquajtur i Trezori i Bankës Postare Kursimore (Banka Postanske Stedionice) dhe pesë filialeve të tjera të saj, që kanë vepruar ilegalisht në këtë zonë të Republikës së Kosovës. Qëllimi i operacionit policor ka qenë vendosja e rendit dhe ligjshmërisë, ku me autorizim të prokurorit kompetent gjashtë njësi të të ashtuquajturës bankës postare kursimore ilegale në veri të vendit janë mbyllur. Gjatë këtij operacioni policor janë konfiskuar prova të ndryshme materiale, siç janë: para në vlerë rreth 1.600.000 euro, 74.700.000 dinarë, 19.500 franga, 13.800 dollarë amerikanë, 40 dollarë australianë, si dhe dokumentacione dhe prova tjera relevante që ndërlidhen me rastin.



Arrestohet një person pasi sulmoi dhe kanosi zyrtarët policorë dhe zyrtarët e KEDS-it



Me datën 18.11.2024 njësitë policore nga Drejtoria Rajonale e Policisë-Mitrovicë Veri, në kuadër të detyrave të rregullta gjersa ishin duke asistuar zyrtarët e Kompanisë Kosovare për Distribimin e Energjisë Elektrike (KEDS) për vendosjen e njehsorëve të energjisë elektrike në lagjen Kroji i Vitakut janë kanosur nga një banor (R.R.) i lindur më 1986. Pas kërcënimeve të vazhdueshme dhe sulmit ndaj zyrtarëve policorë, i dyshuari është arrestuar. Një zyrtar policor ka pranuar tretmanin mjekësor pasi ishte goditur me mjet të fortë. Mbi dyshime të bazuara dhe të arsyeshme njësitë policore kanë kryer bastisje në shtëpinë e personit ku kanë gjetur një sasi të konsiderueshme të mjeteve për prodhimin e kriptovalutave (RIGA) të cilat janë sekuestruar dhe janë dërguar në terminalin doganor.

Të gjitha veprimet e ndërmarra i janë paraqitur Prokurorit të rastit, ku pas intervistimit, me aktvendim të prokurorit i dyshuari dërgohet në mbajtje për 48 orë. Policia vazhdon të mbetet e përkushtuar për ofrim të shërbimeve ndaj të gjithë komunitetit pa dallim si dhe do të sjellë para organeve të drejtësisë të gjithë personat që bien në kundërshtim me ligjin.

Në aeroport sekuestrohen disa pako me cigare

Me datën 14.12.2024 rreth orës 10:35 pas një pune operative policore, në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”, janë vërejtur tre pasagjer meshkuj shtetas të Mbretërisë së Bashkuar, të cilët me datën 13.12.2024 kishin ardhur nga Londra dhe të njëjtit janë vëzhguar/përcjellë nga ana e zyrtarëve policor deri sa janë larguar nga aeroporti. Si rezultat i punës policore, sot zyrtarët policorë kanë vërejtur këta persona/pasagjer të cilët me vete kishin çanta shpine si dhe valixhe tjera dhe për këtë janë informuar stafi i kontrollit (X-rey) në shkuarje si dhe zyrtarët doganor në aeroport. Këta tre pasagjer janë kontrolluar në (X-rey), në prezencë të policisë dhe zyrtarit doganor, ku në bazë të aparatit të kontrollit në (X-rey), është detektuar se në këto valixhe është një sasi e konsiderueshme e pakove me cigare. Të njëjtit janë dërguar te zyrat e Doganës për procedura dhe kontrole të mëtejme, ku pas kontrollit të detajuar të valixheve ka rezultuar se janë 190 (shteka) cigare – Marlboro, të cilat janë sekuestruar nga Dogana e Kosovës, të cilëve edhe i është dorëzuar rasti për veprime të mëtejme.

Përgatiti: Arlinda Rexhepi - Gërxhaliu

Bashkëpunim i frytshëm ndërmjet Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës (SHSKUK) dhe Policisë së Kosovës (PK)



*Përgatitur nga Dr.Lindita Kajtazi
Interniste/Endokrinologe*

Memorandumi i Mirëkuptimit të nënshkruar ndërmjet Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës (SHSKUK) dhe Policisë së Kosovës (PK), për ofrimin e shërbimeve mjekësore dhe psikologjike për personelin policor dhe rekrutët, ka filluar të zbatohet nga nëntori i vitit të kaluar dhe deri më tani, ku implementimi i këtij memorandumi ka rezultuar jashtëzakonisht i suksesshëm. Me datën 03.12.2024 nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, kolonel Gazmend Hoxha dhe nga drejtori i SHSKUK-së Mr. Ph. Elvir Azizi, është nënshkruar vazhdimi i saj, bazuar në suksesin e lartë të implementimit dhe bashkëpunimit.

Ky sukses konsiston në faktin se kontrollimet mjekësore/psikologjike për rekrutët e rinj të PK-së dhe kontrollimi sistematik i punonjësve të PK-së dhe rekrutëve, ka arritur të realizohet në QKUK (Qendrën Klinike Universitare të Kosovës) dhe në spitalet e përgjithshme rajonale të SHSKUK-së (Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës), sipas kritereve mjekësore të përcaktuara nga Drejtoria e Shërbimeve Shëndetësore e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës.

Implementimi i Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet SHSKUK-së dhe Policisë së Kosovës ka pasur një rëndësi të jashtëzakonshme për personelin policor. Ky memorandum ka siguruar mirëqenie shëndetësore në aspektin psiko-fizik, duke përfshirë:

- Zbulimin e hershëm të sëmundjeve të ndryshme,
- Parandalimin e komplikimeve të sëmundjeve kronike,
- Realizimin e kontrolleve mjekësore profesionale nga mjekët specialistë të lëmive të ndryshme ,
- Përcaktimin dhe përshkrimin e terapive adekuate,
- Kryerjen e ekzaminimeve të avancuara diagnostikuese bazuar në indikacionet përkatëse, si: rezonancë magnetike, CT, Echo të zëmrës dhe të sistemeve të organeve të tjera, ergometri etj., koronarografi, vendosje të stendave, bypass etj.

Gjithashtu, ky memorandum ka luajtur një rol kyç në përzgjedhjen e rekrutëve të rinj të Policisë së Kosovës, përmes kontrolleve mjekësore dhe psikologjike në përputhje me standardet mjekësore për aplikantët e rinj të PK-së.

Mirënjohje të thellë për përkushtimin dhe mbështetjen shprehim për të gjithë stafin mjekësor dhe mbështetës të QKUK-së dhe spitaleve rajonale të SHSKUK-së për profesionalizmin dhe përkushtimin e tyre të treguar në vazhdimësi.



Kontributi i mjekëve specialistë të QKUK-së: kardiologëve, kardiologëve invazivë, endokrinologëve, neurologëve, psikiatërve, psikologëve, biokimistëve, dermatologëve, oftalmologëve, ortopedëve, mjekëve të ORL-së, radiologëve, ka qenë i jashtëzakonshëm në kontrollimet mjekësore sistematike të punonjësve të PK-së, kontrollimet mjekësore/psikologjike të rekrutëve të rinj të PK-së, testimet periodike mjekësore/psikologjike për pjesëtarët e Njësive të Specializuara të PK-së.

Po ashtu mirënjohje shprehim edhe për punën e palodhur nga specialistët e tjerë si nga fusha e kirurgjisë, onkologjisë, fiziatrisë, mjekësisë nukleare etj., duke treguar rol të rëndësishëm për sigurimin e shërbimeve cilësore mjekësore për punonjësit e Policisë së Kosovës.


Gjatë zbatimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit, është arritur të funksionalizohet zyra ndërlidhëse ndërmjet SHSKUK-së dhe Policisë së Kosovës, e cila ka kontribuar në rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ofrimin e shërbimeve mjekësore specialistike me kohë për nevojat e personelit policor dhe rekrutëve, duke u bazuar në kapacitetet ekzistuese.

Duke marrë parasysh specifikat e punës së zyrtarëve policorë, që përfshin sforcime të larta psiko-fizike, rëndësinë e rolit të tyre në garantimin e sigurisë së përgjithshme në vend, kushtet dhe standardin jetësor, si dhe faktin se një pjesë e konsiderueshme e tyre janë në moshë të shtyrë, ruajtja e shëndetit e të gjithë personelit policor dhe parandalimi i sëmundjeve apo komplikimeve përmes shërbimeve mjekësore specialistike nga QKUK-ja dhe spitalet rajonale të SHSKUK-së, ka qenë dhe është thelbësore. Kjo ndikon drejtpërdrejt në rritjen e efikasitetit të tyre në përmbushjen e detyrave zyrtare në shërbim të qytetarëve dhe Republikës së Kosovës.

Me datën 03.12.2024 nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, kolonel Gazmend Hoxha dhe nga drejtori i SHSKUK-së, Mr. Ph. Elvir Azizi, është nënshkruar vazhdimi i marrëveshjes së bashkëpunimit e lidhur në mes të Policisë së Republikës së Kosovës dhe Shërbimit Spitalor të Klinikës Universitare të Kosovës për shërbim mjekësor dhe psikologjik të personelit policor dhe rekrutëve, të paafatizuar, marrë parasysh rezultatet e arritura nga implementimi me sukses të lartë të marrëveshjes ekzistuese nga muaji nëntor 2023 – nëntor 2024.



Përdorimi i motorëve të borës nga Policia e Kosovës



*Përgatiti;
Mr. Sc. Shaban Osmanollaj*

Kjo teme paraqet rolin dhe rëndësinë e motorëve të borës në operacionet e patrullimit të policisë kufitare, duke përfshirë aspektet e sigurisë, kontrollit të kufijve, dhe parandalimin e aktiviteteve të paligjshme në kushte dimërore. Fokusohet në rëndësinë e përdorimit të motorëve të borës nga policia kufitare për të siguruar kontrollin dhe sigurinë në kufijtë e vështirë për t'u arritur, duke theksuar përfitimet që ky mjet ofron në kushte të vështira dimërore dhe malore. Kjo e bën të qartë se patrullimi me motorë bore është një mjet kyç në mbrojtjen e kufijve, veçanërisht në rajone të largëta dhe të izoluar. Motorët e borës janë një mjet shumë efikas dhe i nevojshëm për policët kufitarë, pasi ofrojnë mobilitet të lartë dhe aftësinë për të operuar në kushte të vështira dimërore dhe malore. Roli i tyre është i shumëanshëm: nga patrullimi i kufijve dhe parandalimi i aktiviteteve të paligjshme deri të ndihma emergjente dhe shpëtimi. Përdorimi i këtyre mjeteve mund të kontribuon ndjeshëm në forcimin e sigurisë dhe mbrojtjes së kufijve, duke siguruar që zona të izoluar ose të vështira të jenë të mbikëqyruara dhe të kontrolluara në çdo kohë. Në përgjithësi, motorët e borës janë të përdorshëm nga çdo njësi që ka nevojë për të operuar në kushte ekstreme dimërore dhe malore. Përdorimi i tyre është shumë i rëndësishëm për të siguruar shpejtësi dhe mobilitet në terrene të vështira, ku transporti me automjete të tjera është i pamundur. Patrullimi policor me motor bore është një formë e veçantë e patrullimit të policisë që përdor mjete të veçanta si motorra të llojeve të ndryshme, të cilët janë të pajisur për të përballuar kushte të vështira si bora ose kushte të tjera ekstreme. Ky lloj patrullimi është i zakonshëm në zona malore, në rajone me kushte dimërore të ashpra, ku makinat e zakonshme mund të kenë vështirësi në lëvizje për shkak të borës, ngricave dhe terrenit të vështirë. Motorët për patrullim në kushte bore janë të dizajnuar me goma speciale dhe mund të jenë të pajisur me shtesa të tilla si tërheqës për tërhequr makina apo ndihmuar në operacione emergjente, si dhe me drita dhe sirena të pasme për sinjalizim.



Orteki i bores ne fshatin Restelicë- Dragash, viti 2012.

Ata janë përdorur shpesh nga forcat e rendit për të realizuar patrullime dhe mbikëqyrje të zonave të veçanta, shpesh duke ofruar mobilitet më të madh sesa mjetet e zakonshme. Përveç asaj, motorët janë gjithashtu të dobishëm për shpëtimin dhe ndihmën në raste aksidentesh apo situatash emergjente në zona ku ndihma e shpejtë është jetike. Në disa vende, si p.sh. në rajone të dimrit të Evropës Veriore ose në Kanada, patrullimi me motor bore përdoret për të siguruar rendin dhe sigurinë në zonat e izoluar. Ndersa ne Kosove, kryesisht policia kufitare i perdore per patrullim ne zonat malore-kodrinore e ne vende te rendesishme ku zhvillohet qendra te skijimit si ne Brezovice, Boge, Brodë e vende te tjera duke e ditur se kufiri i republikes se Kosoves me vendet fqinje është pothuajse i teri kondrinoro-malor. Patrullimi me motor bore mund të fokusohet në disa aspekte të rëndësishme të këtij aktiviteti, si rëndësia e tij në sigurinë publike, sfidat që hasen dhe teknologjitë e përdorura. Ky shkrim mund të shqyrtojë se si patrullimi me motor bore kontribuon në mbajtjen e rendit dhe sigurisë në zonat që janë të izoluar gjatë dimrit, ku makinat e zakonshme nuk mund të lëvizin. Shembuj konkretë të përdorimit të motorëve për të parandaluar aksidentet, për të ndihmuar në shpëtimin e njerëzve në raste emergjente dhe për të mbikëqyruar zonat ku ndodhin aktivitete të paligjshme, nder me te rendesishmit ishte ne rastin e fshatit Restelice më 11 shkurt 2012, kur nje ortek bore, me thellësi 10 metra dhe me gjerësi 500 metra ka goditur 15 shtëpi duke shkaktuar humbjen e 10 jete njerëzish. Roli i policise kufitare te kosoves ishte shume crucial pasi i doli ne ndihme te gjitha institucioneve te Kosoves duke bere transportmin e viktimave, duke bartur pajisjet adekuate dhe zyrtaret e shpetimit deri ne vendin e ngjarjes. Ose ne komunikaten e policise te lëshuar me date 23.03.2021 thuhet: "Datë 22.03.2021, rreth orës 11:40, në Policinë e Kosovës është pranuar një informatë se në Bjeshkët e Zhurit disa persona hasin në vështirësi si pasojë e dëborës, shpëtohen me moto-sajë nga Policia Kufitare e Kosovës".

— Sindikatë

NDERIMI I ZYRTARËVE POLICORË TË RËNË NË KRYE TË DETYRËS PËRMES LOJËRAVE TRADICIONALE SPORTIVE



Në Qendrën Sportive "Sezai Surroi" në Prizren, Sindikata e Policisë së Kosovës organizoi me sukses Lojërat Tradicionale 2024, një aktivitet që bashkoi përfaqësues të institucioneve shtetërore, sindikatave rajonale dhe ndërkombëtare, si dhe familjarët e zyrtarëve të rënë në krye të detyrës. Ky turne simbolizon nderimin për 23 heronjtë e Policisë së Kosovës, të cilët sakrifkuan jetën e tyre për sigurinë e vendit.

Ngjarja përfshiu gara në futboll, shah dhe shenjëtari, duke nënvizuar jo vetëm përkushtimin sportiv të pjesëmarrësve, por edhe respektin e thellë për ata që nuk janë më mes nesh. Në futboll, ekipi i NJSO Prishtinës zuri vendin e parë, ndërsa në shah dhe shenjëtari triumfuan ekipet e NJSO Mitrovicës. Fituesit u nderuan me medalje dhe kupa, duke përçuar mesazhin e unitetit dhe përkushtimit në kujtimin e heronjve tanë.

Në fjalimet e tyre, përfaqësuesit e Sindikatës, përfshirë znj. Edita Azemi dhe z. Avdi Hoti, theksuan rëndësinë e solidaritetit mes institucioneve dhe komunitetit për të nderuar sakrificat e policëve tanë. Prania e përfaqësuesve nga vendet fqinje dhe nga Këshilli Evropian i Sindikatave të Policisë (CESP) dëshmoi angazhimin për bashkëpunim dhe shkëmbim të praktikave më të mira. Ky aktivitet përmbylli me sukses një ngjarje të pasur me emocione dhe përkushtim, duke u kthyer në një traditë domethënëse për nderimin e guximit dhe përkushtimit të heronjve të Policisë së Kosovës. Lavdi dhe nderim të përjetshëm për ta.


Përgatiti: Çajup KAJTAZI





Foto prezantimi në konferencë, dt. 15 - 17 maj 2024 në Radenc/Maribor

ARKIVI QENDROR I POLICISË PREZANTOHET NË KONFERENCËN NDËRKOMBËTARE NË SLOVENI



*Përgatiti;
Ma. Sami Sallahu
Shef i Sektorit të Arkivit Qendror*

Arkivi Qendror i Policisë së Kosovës, në kuadër të bashkëpunimit të ngushtë që ka me Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, ka bashkëpunim të vazhdueshëm edhe me arkivat tjera të rajonit në rrafshin profesional, si: Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë, Drejtorinë e Arkivave të Turqisë, Drejtorinë e Arkivit të Maqedonisë së Veriut etj. Nga ky bashkëpunim përfaqësues tanë marrin pjesë për çdo vit në konferencat mbarëkombëtare e ndërkombëtare që kanë të bëjnë me trashëgiminë kulturore, arkivat, trajtimin e dokumenteve, legjislacionin relevant, standardet ndërkombëtare, ruajtjen dhe mbrojtjen e fondeve arkivore, qasjen në fondet arkivore, arkivat elektronike etj., sikurse gjatë vitit 2023 me pjesëmarrje dhe paraqitje të kumtesës për Arkivin e Policisë në konferencën e organizuar në Maqedoninë e Veriut në qytetin e Manastirit. Konferenca e radhës gjatë këtij viti (2024) u organizua dhe i zhvilloi punimet në Slloveni. Policia e Kosovës, respektivisht Arkivi Qendror, ka pranuar ftesë zyrtare nga Arkivi i Mariborit të shtetit të Sllovenisë për pjesëmarrje në konferencën vjetore.

Në këtë konferencë ndërkombëtare të organizuar nga Komiteti Organizativ “PAM-Pokrajinski arhiv Maribor” kemi aplikuar me kumtesën: “Parimet e mbrojtjes së informacionit të klasifikuar sipas Ligjit nr.08/l-175, dhe Arkivat e Policisë”. Pasi që komisioni profesional ka shqyrtuar dhe aprovuar temën për prezantim të Arkivit Qendror të Policisë, me përkrahjen dhe mbështetjen e DBNJ dhe me aprovimin e drejtorit të Përgjithshëm, na është mundësuar pjesëmarrja dhe përfaqësimi në këtë konferencë të mbajtur me dt. 15 deri 17 maj 2024 në Radenc/Maribor. Morën pjesë shumë përfaqësues nga vendet e rajonit dhe më gjerë ndërsa nga Kosova, respektivisht Policinë e Kosovës në fushën përkatëse të arkivave e ka prezantuar MA. Sami Sallahu, shef i Sektorit të Arkivit Qendror dhe Kreshnik Xhemali zyrtar i lartë në Njësinë e informacionit të klasifikuar, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë. Tema në fjalë kishte në fokus paraqitjen dhe trajtimin e informacioneve të klasifikuara, kategoritë, mbrojtjen sipas ligjit në fuqi dhe Arkivin Qendror të PK-së.

Ky prezantim u vlerësua lart nga organizatori dhe zgjoi interesim për të gjithë pjesëmarrësit e pranishëm të shteteve të ndryshme. Përveç temës së prezantuar, të veçantë e bënte fakti se është vendosur edhe posteri i ekspozuar gjatë gjithë kohës në ambientet ku mbahej konferenca. Për organizatën tonë Policinë, vlerësojmë se ka qenë me shumë interes pjesëmarrja, shkëmbimi i përvojave në avancimin i njohurive të reja të fushës,

bazuar në standardet ndërkombëtare dhe ndryshimet e legjislacionit ku trajtohen problemet e arkivave, arkivat elektronike, zhvillimi bashkëkohor i tyre, ruajtja e informacionit të klasifikuar, mbrojtja e dokumenteve sekrete dhe arkivore, qasja në informacione, dokumente zyrtare etj.

Me Ligjin për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar Nr.08/L-175, janë të përcaktuara parimet bazë dhe standardet minimale të sigurisë, si një sistem unik për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar lidhur me interesat e sigurisë në Republikën e Kosovës. Ky ligj është në harmoni me legjislacionin e BE-së dhe vendimin e Këshillit mbi rregullat e sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të BE-së dhe zbatohet nga të gjitha institucionet (publike) që ushtrojnë kompetenca ekzekutive, legjislative dhe gjyqësore, për personat fizikë dhe juridikë. Pra, informacioni i klasifikuar në Kosovë mbrohet me ligj ndërsa autoritetet për klasifikimin e informacionit janë krerët e lartë të shtetit dhe institucioneve të sigurisë dhe të drejtësisë. Nivelet e klasifikimit të informacionit: Informacioni nisur nga përmbajtja, vlera dhe interesi shtetëror klasifikohet në katër nivele, afatet e ruajtjes së klasifikimit, janë: “tepër sekret” ruhen 50 vjet, “sekret” 15 vjet, “konfidenciale” 5 vjet dhe ato “të kufizuara” një 1 vit.

Informacioni deklasifikohet vetëm atëherë kur nuk ka nevojë për mbrojtje të mëtejme, kur zbulimi i tij nuk përbën më rrezik për sigurinë e Republikës së Kosovës. Informacioni i cili duhet të dorëzohet në arkiva nuk asgjësohet apo shkatërrohet, por deklasifikohet.

Arkiva Qendrore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Kosovës

Bazuar në strukturën organizative, e cila funksionon në kuadër të Departamentit për Burime Njerëzore/DPP, ka dy njësi organizative: Njësinë e Arkivit dhe Njësinë e Administrimit të Dokumenteve, të cilat ofrojnë shërbime profesionale dhe efikase në fushën e menaxhimit të dokumenteve, evidentimin, protokollimin, seleksionimin, vlerësimin, arkivimin, ruajtjen, asgjësinë e dokumenteve (të zhvlerësuar), si dhe mundësinë e shfrytëzimit apo qasjes në fondin arkivor në formë fizike dhe elektronike, në Policinë e Kosovës

Për funksionimin e këtij sektori dhe ofrimin e shërbimeve të nevojshme është krijuar baza ligjore, rregulloret e brendshme, sipas legjislacionit për arkivat, siç janë: Ligji për arkivat Nr.08/L-111, Ligji për administrimin e punës në zyrë Nr. 04/L-184 dhe akteve nënligjore, bazuar edhe në standardet ndërkombëtare të arkivave moderne. Sektori i Arkivit vepron duke zbatuar rregulloret e brendshme, udhëzimet, Procedurat Standarde të Operimit, listën e kategorive të dokumenteve me afate të ruajtjes, vendimin me “Kodet administrative të klasifikimit të dokumenteve zyrtare” etj. Përveç infrastrukturës ligjore janë krijuar edhe kushte të përshtatshme për ruajtjen e dokumenteve në ambient të sigurt me inventar modern, raftet e metaltë lëvizës (specialë), kamerat monitoruese në depon e Arkivit/DPP, që bëjnë arkivin të jetë funksional në arritjen e objektivave. Fondi arkivor dhe dokumentacioni zyrtar i krijuar dhe i administruar në Policinë e Kosovës janë të mbrojtura me ligj dhe akte nënligjore. Lëndët e vlefshme me afat të gjatë të ruajtjes dorëzohen në Deponë e arkivit si pjesë e rëndësishme për ruajtjen e thesarit të shkruar dhe historikut të organizatës që nga themelimi, ndër vite deri më tani. Lëndët arkivore të Policisë trajtohen dhe mbrohen në kushte adekuate për ruajtjen e lëndës arkivore sipas standardeve bashkëkohore të arkivave moderne.





Njësia K9, pjesë e Policisë së Kosovës, është e specializuar në përdorimin e qenve të trajnuar për zbulimin e drogës, eksplozivëve dhe ndihmën në operacionet kërkim-shpëtim. Me profesionalizëm dhe përkushtim, kjo njësi kontribuon në garantimin e sigurisë dhe rendit publik në vend.



Njësia Rajonale për Reagim të Shpejtë (NJRSH) e Policisë së Kosovës është një forcë e specializuar për menaxhimin e situatave emergjente. E pajisur me teknologji të avancuar, NJRSH siguron rendin dhe sigurinë publike, duke minimizuar rreziqet dhe pasojat



Njësia me vetura inteligjente e Policisë së Kosovës është një strukturë moderne e specializuar, e pajisur me teknologji të avancuar për monitorimin dhe kontrollin e trafikut rrugor. Ajo përdor mjete inteligjente për të identifikuar shkelësit e rregullave të qarkullimit, për të përmirësuar sigurinë në rrugë dhe për të reaguar shpejt në raste emergjente, duke siguruar rendin dhe sigurinë në trafik.



Njësia Speciale Intervenuese e Policisë së Kosovës është një ekip elitari i trajnuar për operacione të rrezikshme, përfshirë kapjen e kriminelëve të rrezikshëm, terroristëve dhe shpëtimin e pengjeve. Ajo përdor armë dhe teknologji të avancuar, për të siguruar rendin dhe mbrojtjen në situata emergjente